KËRKESË
Nr.2207/1, datë 24.3.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Fier-Ballsh-Tepelenë (Povla 2).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Republika e Shqipërisë
MPPTT
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
Drejtoria e Shpronësimeve

Lista e pronarëve që shpronësohet nga rehabilitimi i rrugës Fier-Ballsh-Tepelenë (nr.1-6)

	Pronari								
Nr	Emër	Mbiemër	Nr.pasurive	Sip/shpronësimi are,pemë m^2	Çmimi në lekë/m^2	Vlera në lekë	Vlera e kulturës bujqësore	Vlera e kult dru-frutor	Totali
1	Nuredin	Mukaj	124/9	1066	542	577772	10980		588752
2	Hysen	Mukaj	124/20	1617	542	876414	16979		893393
3	Hysen	Xhaferi	124/25	222	542	120324	2220		122544
4	Shyqyri	Kapllani	124/27	358	542	194036	3401	60000	257437
5	Halil	Halilaj	122/1	1717	542	930614	17170		947784
6	Musa	Kapllani	276/15	27	542	14634			34634
		Shuma				2713794	50750	80000	2844544